



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**  
të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
23.10.2014, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Ylli Hoxha, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së dhe Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së.

**Mungoi :** Cuneyd Ustaibo , shef i GP të KDTP-së.

**Morën pjesë edhe:** Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, Liburn Aliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe përfaqësues nga kjo drejtori, Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, përfaqësuesit e Kompanisë “Vizion Projekt” dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

**REND DITE:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në Planin rregullues të lagjes “Mati 1”, në Prishtinë;
3. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në fshatin Hajvali;
4. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të propozimplanit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes “Sofalia” në Prishtinë;
5. Shqyrtimi i raportit financiar tremujor, për periudhën korrik – shtator 2014;
6. Informatë për zgjidhjen e rastit të pronave në lagjen “Dodona”;
7. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Policisë së Kosovës;
8. Propozimvendimi për ndërtimin e lokaleve afariste me partneritet publiko-privat;

9. Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore;
10. Propozimrregullorja për hapjen e kutive të ankesave;
11. Informatë për fillimin e procesit edukativo-arsimor 2014 - 2015;
12. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së Ismail Qemalit;
13. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së Osman Dumoshit;
14. Të ndryshme.

**Njëzëri u miratua rendi i ditës.**

#### **Pika e parë**

**Dardanë Sejdiu** propozoi që në ekstrakt të ceken se cilës parti i përkasin shefat dhe anëtarët e GP-ve.

**Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

#### **Pika e dytë**

**Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e pëlqimit për ndryshime në Planin rregullues të lagjes "Mati 1" në Prishtinë, Dardan Sejdiu** tha se është fjala për ndryshimin (revidimin) që e funksionalizon rrugën "Enver Maloku".

**Sami Hamiti** theksoi se rastet e tilla të ndryshimit të rrugëve mund të bëhen edhe nga drejtoria, pa pëlqimin e Kuvendit.

**Agim Salihu** sqaroi se ligji i ri e parasheh që në raste të tilla, duhet marrë pëlqimi nga Kuvendi, andaj duhet dërguar në Kuvend.

**Islam Pacolli** përkrahu mendimin që kjo të shkojë në Kuvend, në mënyrë që këshilltarët të njoftohen për ndryshimet.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në Planin rregullues të lagjes "Mati 1" në Prishtinë, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e tretë**

**Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në fshatin Hajvali, Islam Pacolli** shprehu mendimin se parcela sa më e madhe që të jetë, aq më shumë do të ketë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në fshatin Hajvalia dhe u propozua që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.**

## Pika e katërt

**Lidhur me Propozimvendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Sofalia" në Prishtinë,** përfaqësuesja e kompanisë "Vizion Projekt", Jona Burrja, në mënyrë vizuale bëri prezantimin lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Planit rregullues "Sofalia" në Prishtinë.

**Islam Pacolli** pyeti se a kanë bërë ndonjë llogari për këtë lagje, se sa banorë do të ketë, sa shkolla, sa çerdhe etj.

Shkëlqimi, arkitekt i kompanisë, dha sqarime lidhur me pyetjen e z. Pacolli.

**Agim Salihu** dha sqarime, duke cekur se këto plane bëhen për 8 vjet.

**Islam Pacolli** pyeti se me këtë planifikim a parashihen rrënimë të shtëpive, objekteve etj.

Përfaqësuesja e kompanisë tha se parashihen rrënimë, por Komuna, gjegjësisht Drejtoria e Urbanizmit është ajo që merret me këtë problem.

**Ylli Hoxha** tha se gjendja reale nuk është e bazuar në ligj.

**Sami Hamiti** kërkoi që Plani zhvillimor urbanistik të analizohet mirë. Do të duhej të kërkohet nga hartuesit e Planit zhvillimor urbanistik, interpretim për atë pjesë, në mënyrë që, në afat prej 15 ditësh, të ju jepet sqarim për Planin zhvillimor.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Sofalia" në Prishtinë, në mënyrë që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.**

## Pika e pestë

**Lidhur me Shqyrtimin e raportit financiar tremujor, për periudhën korrik-shtator 2014,** dha sqarime **Dardan Sejdiu.**

**Visar Berisha** informoi në pika të shkurta lidhur me raportin financiar tremujor, për periudhën korrik-shtator 2014.

**Kryesuesi** tha se duhet të bëhet një korigjim, në faqen 4, tabela 2 të korigjohet, muaji *janar*, duhet të jetë *korrik*, si dhe të korigjohen edhe faqet tjera lidhur me këtë çështje.

**Sami Hamiti** tha se dy kërkesa që i ka bërë lidhur me infrastrukturë, nuk janë marrë parasysh. Ai kishte kërkuar që të dihet se sa procedura janë shkuar, sa prej tyre janë investime kapitale dhe në çfarë faze janë, të përgatiten në tabela, njëherësh kishte kërkuar që të shikohen edhe grantet, sepse duhet të harxhohen.

**Ylli Hoxha** u shpreh i pajtimit me Samiun, sepse ka pasur kohë të shikohen këto punë për grantet e përgjithshme. I parashtroi pyetje drejtoritë të Financave dhe Pronës lidhur me arkëtimin e ulët nga inspektorati, taksat e kadastrit dhe transaksionet. Pse ka ngecje, cila është arsyeja objektive?

**Visar Berisha** theksoi se kishte kërkuar nga Inspekcioni arsyetim për këtë çështje, ndërsa për taksat nga Kadastrit dhe Gjeodezia nuk kanë të dhëna dhe nuk i kishin kërkuar. Po ashtu edhe në transaksion ka rënie.

**Muhamet Selmani** bëri vërejtje për dinamikën e punës, duke kërkuar që të punohet edhe më shumë për këto grante, në mënyrë që të mos mbesin.

**Islam Pacolli**, kërkoi që investimi i kapitaleve të shkojë në shfrytëzim.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Shqyrtimi i raportit financiar tremujor, për periudhën korrik - shtator 2014, në mënyrë që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.**

#### **Pika e gjashtë**

**Lidhur me Informatën për zgjidhjen e rastit të pronave në lagjen “Dodona” informoi Visar Berisha, duke sqaruar se lidhur me këtë çështje është formuar një grup punues, prej 3 përfaqësuesve të pronave të lagjes “Dodona” dhe investitorit, dy përfaqësues nga drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, 2 përfaqësues nga Drejtoria e Financave dhe Pronës dhe një arkitekt i pavarur. Ai tha se kanë mbajtur tri takime me këtë grup punues dhe kanë ofruar 5-6 zgjidhje lidhur me këtë çështje, mirëpo në fund kanë ardhur me një propozim prej tri zgjedhjesh të mundshme.**

**Kryesuesi** kërkoi që të përcaktohen për njërën nga tri opsionet, që sa më shpejt të bëhet zgjidhje.

**Muhamet Selmani** shprehu mendimin se duhet të merret një vendim i prerë sa më parë nga opsioni më i mundshëm.

**Sami Hamiti** kërkoi të dilet me të dhëna deri ku janë pajtuar me pronarët e pronave të lagjes “Dodona”, pastaj të shkohet më tutje.

**Ylli Hoxha** u interesua se deri ku ka arritur çështja e marrëveshjes në mes të Komunës dhe pronarëve të pronave në lagjen “Dodona”, me çfarë plani dhe te cili variant kanë mbërritur.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për zgjidhjen e rastit të pronave në lagjen “Dodona” dhe u propozua që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.**

#### **Pika e shtatë**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Policisë së Kosovës dhe u propozua që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.**

#### **Pika e tetë**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndërtimin e lokaleve afariste me partneritet publiko-privat dhe u propozua që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.**

#### **Pika e nëntë**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Informata lidhur me të mbjellat vjeshtore dhe u propozua që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.**

## **Pika e dhjetë**

**Agim Salihu** dha sqarime lidhur me **Propozimrregulloren për hapjen e kutive të ankesave.**

**U konstatua se u përkrah Propozimrregullorja për kutitë e ankesave dhe u propozua që lënda të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.**

## **Pika e njëmbëdhjetë**

Sa i përket **Informatës për fillimin e procesit edukativo- arsimor 2014 - 2015, kryesuesi** tha se materiali nuk është kompletuar, andaj mbetet të plotësohet nga Drejtoria e Arsimit.

**U konstatua se u përkrah Informata për fillimin e procesit edukativo-arsimor 2014 - 2015, me sugjerim që të plotësohet informata nga Drejtoria e Arsimit.**

## **Pika e dymbëdhjetë dhe e trembëdhjetë**

Sa i përket **Propozimit për gjetjen e lokacionit për ngritjen e shtatores së Ismail Qemalit dhe Propozimit për gjetjen e lokacionit për ngritjen e shtatores së Osman Dumoshit, Kryesuesi** tha se nuk është materiali i përgatitur, andaj këto dy propozime të përgatiten për Kuvend.

**U konstatua se u përkrahen këto dy propozime: Propozimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së Ismail Qemalit dhe Propozimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së Osman Dumoshit, që të përgatiten dhe të dërgohen në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e katërbëdhjetë**

### **Të ndryshme**

**Dardan Sejdiu** theksoi se e kishte marrë një shkresë nga Ministria e Pushtetit Lokal lidhur me themelimin e NPL "Prishtina Parking" SH.A. Fjala është për Vendimin mbi themelimin e NPL "Prishtina Parking" SH.A. dhe për emërtimin e Komisionit komunal të aksionarëve. Ai tha se kjo nuk e sfidon ligjin, se vendimi është në frymën e ligjit, por qëllimi i tyre është zvarritja e vendimit. Kërkoj nga Zyra ligjore interpretim për hapat e ardhshëm: të përgatit vendim i ri, të mbesin këto materiale, të dilet në Kuvend me propozim që po e ndryshojmë vendimin, apo ta dorëzojnë materialin në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

**Muhamet Selmani** kërkoi që të gjendet formë e shpejtë për të reaguar lidhur me këtë çështje.

**Sami Hamiti** shprehu mendimin se duhet të kërkohet takim me Komisionin ndërministror.

**Ylli Hoxha**, në emër të GP të LVV-së, kërkoi nga kryesuesi që asamblistëve të u sigurohet një sallë për takime dhe një kompjuter.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:20.*

**Procesmbajtës :**  
**Zijadin Gashi**  
**Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Halim Halimi, jur.i dipl.**